

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Mbështetja / *et-Tewekkul* /

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

"وَعَلَى اللَّهِ فَتَوَكَّلُوا إِن كُنْتُمْ مُؤْمِنِينَ"

“Te Allahu mbështetuni, në qofshi besimtarë.” (el-Maa’ideh, 23)

Mbështetja në Allahun do të thotë t’ia dorëzosh të gjitha çështjet pronarit (absolut) të tyre dhe të kesh besim në ndikimin e Tij. Për shumicën e besimtarëve kjo është shkalla më e vështirë, kurse për elitën e besimtarëve kjo është shkalla më e dobët.¹ Kjo sepse i Vërteti, më i Larti, ia besoi të gjitha çështjet Vetes së Vet dhe nuk i la krijesat të shpresojnë se do të mund të pronësojnë në çfarëdo mënyrë cilëndo prej çështjeve. Kjo ka tri nivele dhe të gjitha i përkasin shtegut të besimtarëve të rëndomtë.

Niveli i parë: Mbështetja e shoqëruar nga ndjekja (e nevojave) dhe zbatimi i shkaqeve,² me qëllim që:

- Ta mbash të zënë *nefsin* (vetveten)³

¹ Shih diskutimin e nivelit të tretë lidhur me pozitën e mbështetjes (*tewekkulit*) së përsosur në Allahun dhe të qenët e saj një nga shkallët e peygamberëve dhe të Dërguarve të Tij. Ajo çfarë mund të ketë pasur si qëllim shejhu (el-Harawi) këtu është se format elementare të mbështetjes janë të lehta për elitën e besimtarëve, të cilët janë të bindur plotësisht se i gjithë ndikimi (*hawl*) dhe fuqia (*kuweh*) i përkasin Allahut. Shejhu po ashtu mund të ketë menduar se formave elementare të mbështetjes mund t’u mungojë *tefwidi* (lënia në dorë e çështjes) i plotë, por kjo s’do të ishte me vend në rastin e mbështetjes së plotë që peygamberi ﷺ u urdhërua ta bënte.

² Të mbështetesh në Allahun ndërsa i zbaton shkaqet, që është furnizimi dhe bërja e kujdesit, gjë që përfshin fitimin e parasë, të fuqisë, të dijes dhe të pozitës me nijet fisnik.

³ Sepse, nëse *nefsi* (egoja) nuk mbahet i zënë me atë që është e dobishme, do të angazhohet në atë që i bën dëm.

- T'u bësh dobi krijesave⁴
- Të heqësh dorë nga pretendimet⁵

Niveli i dytë: Të mbështetesh në Allahun ndërsa nuk bën asnjë kërkesë⁶ dhe shikon përtej shkaqeve⁷:

- Të përpiqesh ta rregullosh mbështetjen që ke
- T'i frenosh aspiratat e tepërta vetjake
- Ta ruash kohën për kryerjen e obligimeve

Niveli i tretë: Të mbështetesh në Allahun ndërsa je plotësisht i vetëdijshëm për kuptimin e mbështetjes dhe kësisoj të ikësh nga vështirësitë e mbështetjes:

Ky nivel realizohet duke ditur se pronësia e Allahut është një pronësi e fuqisë absolute dhe Ai s'ka ortak i cili do t'ia linte në dorë ndonjë nga çështjet e tij. Është pjesë qenësore e robërimit të robit ndaj Allahut që të dijë se Ai – i lartësuar qoftë! – është pronari i vetëm i të gjitha gjërave.⁸

⁴ T'i bësh dobi vetes dhe krijesave të tjera, përfshirë familjen, fqinjët, umetin, njerëzimin në përgjithësi.

⁵ Të heqësh dorë nga pretendimet për arritjen e një shkalle më të lartë. Kështu, ti angazhohesh në shkaqe, në mënyrë që ta parandalosh *nefsin* të pretendojë se ka arritur të lartësohet mbi ndjekjen e nevojave apo angazhimin në shkaqe; ti po ashtu angazhohesh në shkaqe, me qëllim që njerëzit të mos të atribuojnë ty shkallë më të larta.

⁶ Të mos u kërkosh krijesave përmbushjen e nevojave tua, por këtë ta kërkosh nga Allahu. Muslim shënoi se Malik el-Eshxha'i tha: "... Ne thamë: 'Na trego, o i Dërguar i Allahut, për çfarë të të zotohemi?' Ai ﷺ tha: 'Që ta adhuron vetëm Allahun dhe të mos i veni ortak ndonjë gjë, të falni pesë kohët e namazit, të jeni të dëgjueshëm dhe – e tha nën zë – të mos u kërkoni gjë njerëzve.' Paskëtaj kam parë disa nga të pranishmit të mos u kërkonin njerëzve t'ua jepnin as kamxhikun që u binte ndërsa gjendeshin mbi kafshën kalëruese." Në *Medaarixh*, Imam Ibn el-Kajjim thotë se Shejhul-Islam Ibn Tejmije thoshte se t'u lypësh njerëzve është padrejtësi ndaj zotësisë së Allahut, gjë që bëhet duke pritur ndihmë prej tjetërkujt pos Tij, duke e poshtëruar vetveten me lypje, dhe duke u lypur njerëzve atë që ata e duan.

⁷ Në *Medaarixh*, Imam Ibn el-Kajjim përmend sesi i Dërguari i Allahut ﷺ, ai që më së miri i është mbështetur Allahut, angazhohej në shkaqe duke bërë plane, duke bërë kujdes, duke u furnizuar, duke gjykuar çështjet sipas rezultateve të pritshme, etj.

⁸ Shejhu (el-Harawi) mund të ketë menduar se një nga problemet e mbështetjes është se i mbështeturi i lë në dorë Allahut atë çfarë gjithmonë ka qenë e Allahut, kështu që kjo lënie në dorë nuk mund të merret me mend. Imam Ibn el-Kajjim i kërkoi falje shejhut që iu desh ta kundërshtonte në këtë çështje dhe përmendi se Allahu

urdhëroi krijesën e Tij më të mirë që t'i mbështetej, kur tha: “Atëherë, mbështetu te Allahu, se ti, me të vërtetë, je në të vërtetën e qartë” (en-Neml, 79). Kjo do të thotë se mbështetja te Allahu apo *tewekkuli* është një nga shkallët më të larta. Ai vazhdoi të argumentonte se mbështetja e përsosur, në fakt, është një rezultat i të kuptuarit se Allahu është pronari dhe kontrolluesi i vetëm i të gjitha gjërave, kështu që mbështetja nënkupton që t'i besosh pronarit atë që ai posedon dhe të mbështetesh te Ai për nevojat, punët dhe fatin tënd, pasi ta njohësh mungesën e plotë të ndikimit (*hawl*) dhe të fuqisë (*kuweh*) në veten tënde.